



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

### PROCESVERBAL

(i përmbledhur)<sup>1</sup>

Tiranë, më 21.12.2020, ora 12.00

Drejton mbledhjen -

Vitore Tusha – zv/Kryetar i Këshillit

*Rendi i Ditës:*

*Miratimi i procesverbalit të përmbledhur të mbledhjes të KED-së të datës 11.12.2020 dhe të datës 14.12.2020.*

#### **Marrin pjesë :**

- |                     |              |
|---------------------|--------------|
| 1. Vitore Tusha     | (zv/kryetar) |
| 2. Fiona Papajorgji | (anëtare)    |
| 3. Arta Marku       | (anëtare)    |
| 4. Miranda Andoni   | (anëtare)    |
| 5. Saida Dollani    | (anëtare)    |
| 6. Ludovik Dodaj    | (anëtar)     |
| 7. Fatjona Memçaj   |              |

#### **Merr pjesë, si vëzhguese e përherëshme:**

1. **Avokati i Popullit**, përfaqësuar me autorizim nga **Enio Haxhimihali**.

#### **Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:**

1. **Bledar Dervishaj**, përfaqësues me autorizim i Presidentit të Republikës.

#### **Merr pjesë përfaqësuesja e OPDAT.**

1. **Klodiana Vogli**.

<sup>1</sup> Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja “d”, neni232 pika 2, neni 242 shkronja “c”) dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe të zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

## HAPET MBLEDHJA

**Vitore Tusha** hap mbledhjen dhe parashtron se kjo mbledhje është thirrur për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së shkuar e cila ka filluar në datën 11.12.2020 dhe është mbyllur në datën 14.12.2020.

Verifikon praninë e anëtarëve dhe pjesëmarrësve në mbledhje. Anëtarët janë të pranishëm.

Avokati i Popullit përfaqësohet me autorizim nga z. Enio Haxhimihali. Është i pranishëm përfaqësuesi i Presidentit të Republikës, por nuk është e pranishme përfaqësuesja e Kryetarit të Kuvendit dhe as përfaqësuesit e Komisionit të Ligjeve.

Në mbledhje merr pjesë dhe përfaqësuesja e OPDAT, znj. Klodiana Vogli.

Përpara se të kalojnë te rendi i ditës informon Këshillin në lidhje me dy çështje.

Së pari, lidhur me shkresën e datës 16.12.2020 të Presidentit të Republikës, në të cilën shpreh vullnetin institucional që Këshilli të vijojë me shpejtësi procedurat për dy vakancat e shpallura prej tij. Anëtarëve u është vënë në dispozicion kopje e shkresës.

Së dyti, lidhur me vakancën e Presidentit të shpallur në datën 22.11.2019, e cila është në proces për shkak të shfuqizimit të vendimit të KED nga Gjykata Administrative e Apelit për kandidaten Zhaklina Peto. Vë në dijeni Këshillin se, edhe pse nuk është në rendin e ditës, ka vlerësuar të informojë se kandidatja Zhaklina Peto i është drejtuar Këshillit me kërkesë për të shtyrë të gjithë procedurën duke paraqitur si arsye se është e sëmurë me Covid-19 dhe mjeku i ka lëshuar raport mjekësor për 14 ditë, i cili përfundon në datën 1 Janar të vitit tjetër. Në vijim kandidatja ka paraqitur dhe një e-mail tjetër, me të cilin i ka bërë disa pyetje relatores, dhe kjo e fundit e ka informuar që të gjitha shqetësimet dhe pyetjet e ngritura do t'i paraqiten Këshillit. Më më pas i është drejtuar përsëri Këshillit ku shprehet se është në pritje të përgjigjeve dhe prandaj nuk po vijon me shpjegimet dhe shprehet se është treguar bashkëpunuese, ka ardhur në Këshill dhe ka marrë dokumentat. Sqaron Këshillin se dokumentet e ardhura të reja, i janë përcjellë kandidatës të skanuara.

Kandidati ka ngritur si pyete nëse Këshilli do të mblidhet jashtë radhe për të diskutuar vetëm kërkesën e saj për sqarime. Po ashtu, sqaron se kandidatja nuk shprehet në lidhje me pasjen e ndonjë avokati apo mundësinë për të gjetur një avokat.

Fton anëtarët të shprehen por pasi të miratohet procesverbali, që është dhe rendi i ditës.

**Anëtarët** shprehen se janë dakord me rendin e ditës dhe miratojnë procesverbalin e përmbledhur të mbledhjes të KED të datave 11.12.2020 dhe 14.12.2020.

**Vitore Tusha** pyet nëse përfaqësuesit e Avokatit të Popullit dhe Presidentit kanë gjë për të shtuar?

**Enio Haxhimihali** shprehet se është dakord me procesverbalin.

**Bledar Dervishaj** shprehet se është dakord me procesverbalin. Pyet relatoren nëse kandidatja ka pasur afatin e fundit ditën e djeshme?

**Miranda Andoni** përgjigjet se mbaronte ditën e dielë por meqenëse ishte ditë pushimi afati përfundoi ditën e hënë. Sot i përfundonte afati 5 ditor për dhënien e qëndrimeve dhe shpjegimeve nga ana e kandidatit.

**Bledar Dervishaj** pyet nëse e ka paraqitur testin e Covid me rezultat?

**Miranda Andoni** përgjigjet se po, me rezultat dhe se mund të njihen me të nëse dëshirojnë. Bashkëlidhur ka paraqitur rezultatin e Institutit të Shëndetit Publik, të datës 19.12.2020 ku ka rezultuar pozitive, ndërkohë raporti për paaftësi të përkohshme është marrë që prej datës 18.12.2020.

**Vitore Tusha** ndërhyt dhe shprehet se data e mbërritjes në ISHP është 18.12.2020.

**Miranda Andoni** sqaron se ky është rezultati i testit 19.12.2020, raporti mjekësor është 18.12.2020. Data e mbërritjes është 18.12.2020 ndaj tha se edhe raportin mjekësor e ka filluar në këtë datë se ashtu e kanë praktikën dhe se mund t'i shikojnë aktet.

**Bledar Dervishaj** merr fjalën: “Jo nuk ka nevojë t'i shikoj. Pyetjet që duhet të shtrojnë Këshilli për diskutim janë: A e pezullon afatin ligjor ky fakt apo jo? Dhe a ka mundësi kandidatja të mbrohet përmes përfaqësuesit të saj, siç është mbrojtur në të gjithë proceset gjyqësore? Qëndrimi jonë si organ i emërtesës, siç kemi kërkuar edhe me shkrim, është që duhet të mbyllet brenda 31 dhjetorit. Ky është qëndrim i pandryshuar, të dyja vakancat, qoftë për njërin qoftë për tjetrën, në të dyja datat kur janë shqyrtuar kandidatët kemi kërkuar të futet Këshilli në vlerësim jo më kot, sepse nuk kemi kohë. Kanë ngelur tashmë edhe 10 ditë, as 10, 9, minus një ditë pushimi në datë 25, vetëm 9 ditë i ka ngelur Këshillit. Kështu që edhe për Klajdi Monen që sot ka një gjyq në orën 2, Këshilli duhet të krijojë mundësinë të mblidhet shumë shpejt që të futet në proces vlerësimi. Qëndrimi jonë është po ai i shprehur nga Presidenti në letrën datë 16, i pandryshuar. Këto dy vakanca duhet të përfundojnë brenda këtij viti. Janë të gjitha mundësitë. Pastaj, vendimmarrja, diskutimi etj, është përgjegjësi e Këshillit por qëndrimi jonë nuk ka ndryshuar.”

**Vitore Tusha** pyet anëtarët nëse kanë ndonjë gjë për të shtuar.

**Saida Dollani** kërkon fjalën. Shprehet se është ligjërish e parashikuar që është relatori që vendos mbi hartimin e relacionit dhe përcjelljen e çështjes duke e njoftuar kryetarin për dërgimin e çështjes në mbledhje, por u dha një informacion dhe u kërkuar mendimi i anëtarëve të Këshillit, i cili vepron si organ kolegjal ku nuk i duhet bërë bisht çdo lloj detyre apo përgjegjësie. Referuar qëndrimin konsekuent që Presidenti mban, aq më tepër tashmë e thënë në mënyrë eksplicite nga përfaqësuesi i tij në këtë mbledhje, si dhe duke përballur gjithë qëndrimin e zotit President me faktin që drejtohet tani nga zonja Peto, vëren se bazuar në aktin që zonja Peto ka paraqitur nuk ka një parashikim ligjor për të bërë një pezullim të procedurave apo për të bërë një shtyrje. Kandidatja i ka të gjitha mundësitë, asaj i kërkohe shpjegime nuk i kërkohe më mbrojtje. Nuk bëhet fjalë për një procedurë të mbrojtjes, për më tepër që është hera e tretë që shikohet kandidatura. Znj.Peto nëse e shikon të domosdoshme që ka nevojë për një përgjigje më të specializuar ka të gjithë të drejtat të zgjedhë një përfaqësues, ashtu siç e tha dhe përfaqësuesi i Presidentit, gjë që e ka bërë kur mbrohet para gjykatës. Znj. Peto i kërkon shpjegime Këshillit gjë që e sheh shumë të rëndë, pasi KED nuk jep asnjë lloj përgjigje dhe nuk mund t'i drejtohet asnjë lloj pyetje përveçse kandidati t'i përgjigjet, bazuar në ligj dhe aktet normative. Nëse ka shpjegime për të dhënë ka të drejtën për t'i dhënë, nëse nuk ka mund të mos i japë dhe Këshilli vepron. Përfundimisht shprehet se bazuar si në ligjin nr. 115/2016, aktin normativ nr.4 të KED, në qëndrimin konsekuent të Presidentit, ashtu edhe në opinionin e Venecias, që në pikën 101 të Kreut të IV në konkluzione e thekson se është me rëndësi jetike për Shqipërinë që të ripërtërijë sa më shpejt Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë, aq më tepër kur dihet që shqyrton çështje komplekse që kanë të bëjnë me kushtetushmërinë e çështjeve

me një interes publik, Këshilli të vazhdojë me procedurat pasi nuk përbën asnjë shkak ligjor fakti i sjellë në dijeni të Këshillit nga znj.Peto.

**Fiona Papajorgji** shprehet se do të donte të dëgjonte njëherë mendimin e relatores duke qenë se ndjek ajo procedurat. Mendon se nga data 15 që kandidates i janë komunikuar gjetjet deri në datën 18 kur kanë filluar dhe dyshimet për covid për kandidaten, ka qenë një kohë e konsiderueshme që përgjigjet të ishin përgatitur. Nga momenti që kandidatja ka shkruar e-mail mendon se ajo mund të përcjellë përgjigjet që mund të kishte përgatitur, por shprehet se situata e gjendjes shëndetsore të kandidates mund të jetë dhe ndryshe. Nga ana tjetër mendon që mund t'i jepet kandidates të paktën një ditë që nëpërmjet përfaqësuesit të saj të ketë mundësinë të japë shpjegimet e mundshme, pas gjetjeve që i janë adresuar. Duke qene se e drejta e mbrojtjes është e drejte kushtetuese e garantuar për të gjithë kandidatet, mendon se 24 orë mund t'i garantohen kandidates. Rithekson se kandidatja ka pasur kohë të mjaftueshme që materialet t'i ketë përgatitur.

**Miranda Andoni** merr fjalën dhe është e mendimit që duhet të vazhdohet me procedurën e verifikimit. Pyetjet ose sqarimet e kërkuara kandidates kanë qenë pikërisht për gjetjet, për të cilat kandidatja ka qenë në dijeni dhe ka dy vendimmarrje të mëparshme. I gjithë hetimi vazhdon përsëri për të njëjtat gjetje, kështu që kandidates nuk i është dashur kaq shumë kohë që të përgatitet në lidhje me çfarë i është kërkuar nga Këshilli. Që ditën e hënë deri ditën e premte kandidatja i ka pasur mundësitë të njihet me aktet, i janë komunikuar aktet e reja, është paraqitur në KED, ka tërhequr aktet që ajo ka vlerësuar se do të shërbenin në lidhje me kthimin e përgjigjes që i është kërkuar. Mendon se duhet të vazhdohet pasi koha në dispozicion ka qenë e mjaftueshme.

**Arta Marku** shprehet se nuk ka mendim ndryshe nga i kolegëve. Nuk ka një parashikim ligjor për të pezulluar afatet, të cilat ecin njësoj për të gjithë kandidatët dhe se nuk është e domosdoshme prania e kandidates që Këshilli të mos e zhvillojë mbledhjen, kështu që mendon se mund të vazhdojë mbledhja.

**Ludovik Dodaj** shprehet se nuk mund të bëhet një raport pengesë për këtë vend vakant të Presidentit dhe se nuk e sheh të domosdoshme praninë e kandidates. Mendon që të vazhdohet puna me gjetjet, pasi në një konkurrim me shpallje për vend vakant Këshilli merr në analizë çështjet brenda procedurave dhe afateve.

**Fatjona Memçaj** merr fjalën dhe shprehet se nuk mund të pezullohet procedura pasi nuk ka asnjë shkak të arsyeshëm apo argument ligjor, aq më shumë kur paraqiten edhe të dhëna të sakta që kandidatja është mbrojtur me përfaqësues ligjor, të cilët e njohin situatën ligjore dhe faktike mbi të cilën ajo ndodhet në raport me procesin. Është dakord që t'i jepet një afat kohor, nuk mund të thotë orë, ditë, sepse kjo varet nga relatori që përgatit relacionin, i cili do caktojë datën e re dhe do jetë relatori që ka në dorë gjithë procesin. Nuk mund të caktojë një afat kohor por ai të jetë aq i arsyeshëm që dhe kandidates t'i jepet edhe njëherë mundësia që të thotë fjalën e fundit. Në asnjë mënyrë nuk mendon që të pezullohen procedurat. Nuk e vë në dyshim që ajo mund të ketë shkak shëndetësor, por bëhet fjalë për gjetje dhe diskutime që janë bërë dhe ribërë disa herë në Këshill dhe kandidatja është njohur, rinjohur nuk ka një gjetje e re, p.sh. që ajo do paraqesë një dokument, ku dhe mund të vështirësohej situata pasi nuk mund ta gjejë për shkak të situatës shëndetësore. Në këtë situatë nuk e quan të arsyeshme kërkesën e saj.

**Vitore Tusha** i jep fjalën përfaqësuesit të Avokatit të Popullit të shprehë mendimin e tij.

**Enio Haxhimihali** shprehet se sipas autorizimit të paraqitur para Këshillit ka qenë i autorizuar për tjetër gjë dhe se nuk ka tagër për të diskutuar mbi këtë çështje. E gjykon të nevojshme për ta konsultuar me titullarin e institucionit pasi të ketë dhe praktikën, kështu që rezervon të drejtën për këtë pjesë.

**Vitore Tusha** ndërhyr dhe shprehet se gjithë çështja është që Këshilli të zhvillojë të gjithë elementet e procesit të rregullt ligjor me detaje dhe pa asnjë paragjykim, por duke i dhënë rëndësi pasi kemi të bëjmë me një të drejte dhe kompetence të Këshillit për tu zbatuar me korrektësi të gjitha kompetencat që ka. Por vendosja në balancë e interesave të Shqipërisë dhe të individit duhet të jetë në vlerësimin e gjithsecilit në këto procedura që kanë mbetur për tu zhvilluar.

**Vitore Tusha** pyet nëse përfaqësuesja e OPDAT ka diçka për të shtuar.

**Klodiana Vogli** shprehet se OPDAT nga ambasada amerikane është dakord me të gjithë anëtarët e Këshillit që janë të mendimit për të vazhduar procedurën dhe që kandidatja ka pasur të gjithë mundësinë për t'iu përgjigjur në kohë pyetjeve të drejtuara nga ana e Këshillit.

**Saida Dollani** shprehet se meqenëse nga znj. Papajorgji dhe znj. Memçaj u tha, sigurisht që është në kompetencën e relatorit, por edhe referuar praktikës së ndjekur, një rast po i mirë i jepet znj.Peto pa i dhënë asnjë ditë afat po nëpërmjet relacionit, duke ju dërguar relacioni ajo ka të drejtën të mbrohet. Sjell në vëmendje rastin e z.Hasanaj që pasi iu çua relacioni solli shpjegimet dhe Këshilli i mori në konsideratë, i bëri pjesë të procesit aktet që ai solli. Asgjë nuk i mohohet znj.Peto duke i çuar relacionin nqs relatoria tha që nuk është për t'i dhënë asnjë ditë kohë.

**Bledar Dervishaj** pyet nëse do i jepet kohë kandidates?

**Vitore Tusha** shprehet se në varësi të vendimmarrjes së sotme nga Gjykata e Apelit do merren vendimet e duhura për ecurinë e vakancës.

Deklaron mbylljen e mbledhjes.

**Mbyllet mbledhja në orën 12:25**

**Tiranë, më 21.12.2020**

**ANËTARE**  
**Arta MARKU**

**ANËTARE**  
**Fiona PAPAJOJGJI**

**ZV/KRYETAR**  
**Vitore TUSHA**

**ANËTARE**  
**Saida DOLLANI**

**ANËTARE**  
**Fatjona MEMÇAJ**

**ANËTAR**  
**Ludovik DODAJ**

**ANËTARE**  
**Miranda ANDONI**

**SEKRETARE**

**Ermelinda KADIU**

**Elona Kardhiqi**